



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

---

**Datë:** 15.07.2025  
**Numër Protokolli:** 4784/2025

**A.nr.915/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.915/2025, të datës 15.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.H, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.07.2025, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës A.nr.915/2025, të datës 20.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.H

**A r s y e t i m**

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.H (tutje referuar: ankuesi), më datë 15.05.2025 përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshilli më datë 20.05.2025, e regjistruar nën shenjen A.nr.915/2025, kundër procedurës së rekrutimit sipas Konkursit të Jashtëm me Nr.01/2025, për pozitën e punës Referent në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, i njëjti më datë 15.07.2025, përmes e-mailit zyrtar (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar kërkesë e për tërheqje të ankesës me numër A.nr.915/2025 të datës 20.05.2025, duke mos specifikuar arsyet e tërheqjes së ankesës.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 15.07.2025 për tërheqje nga ankesa e datës 20.05.2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës A.nr.915/2025, të datës 20.05.2025.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda

*afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.915/2025**

**Kaltrina Prenaj**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj-Demi**

*Kryetare e Kolegjit*

***Vendimi i dërgohet:***

- *Ankuesit, A.H;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*